# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**
**www.qpz.gov.al**

**Nr.138 23 shtator 2009**


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret nr.6241 datë 9.9.2009 | Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare ..... | 6367 |
| Dekret nr.6242 datë 9.9.2009 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare ..... | 6367 |
| Vendim i KM nr.903, datë 26.8.2009 | Për krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) ..... | 6368 |
| Vendim i KM nr.916, datë 15.7.2009 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", të ndryshuar ..... | 6371 |

**DEKRET**
**Nr.6241, datë 9.9.2009**

**PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Agron Tusho Gjataj
2. Anita Ahmet Gjataj (Rama)
3. Fiona Agron Gjataj
4. Etleva Eqerem Rulfs (Shemai)
5. Lumturie Ibish Llapi
6. Mirash Ndue Ndoj
7. Shqiponja Gjergj Dodaj
8. Elton Neim Nielsen (Dervishi)
9. Diana Afrit Qoli
10. Elida Loni Zoni (Shytermeja)
11. Vledian Petrit Shehi
12. Natasha Lazar Gerken (Tegu)
13. Munir Hysen Martini
14. Ilda Bashkim Heims (Muka)
15. Agron Asllan Mija
16. Merita Teofik Hoxha (Kokomani)
17. Edlira Zihni Hoxha
18. Blerina Zihni Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Bamir Topi**

**DEKRET**
**Nr.6242, datë 9.9.2009**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Marcel Ernst Steiner
2. Fatme Mohammad Chehab
3. Bekim Bajram Belegu
4. Blinera Bekim Belegu
5. Blin Bekim Belegu
6. Maide Ismail Bardhi
7. Ali Galip Ali Ozturk
8. Rrahman Xhemali Kukaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Bamir Topi**

**VENDIM**
**Nr.903, datë 26.8.2009**

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (AKTI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI), si një institucion juridik publik, në varësi të Këshillit të Ministrave. AKTI-ja e ka selinë në Tiranë dhe ka stemën e vet.

2. AKTI-ja ka mision mbështetjen, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe të projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (SHTI), në shkallë vendi.

3. AKTI-ja, për të realizuar misionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, kryen detyrat e mëposhtme:

a) Bashkëpunon me ministritë dhe institucionet e tjera për zbatimin e strategjisë së SHTI-së dhe promovon kërkimin në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit;

b) Realizon financimin e programeve dhe të projekteve të SHTI-së, në përputhje me përparësitë e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe me vlerësimin e bërë nga komisionet përkatëse;

c) Zhvillon procedurat e aplikimit, të vlerësimit fillestar, monitorimit dhe vlerësimit përfundimtar të programeve dhe projekteve të SHTI-së;

ç) Monitoron dhe vlerëson veprimtaritë e SHTI-së, në shkallë vendi;

d) Krijon dhe pasuron, në mënyrë të vazhdueshme, bazën e të dhënave, të analizës dhe dokumentacionit të sistemit të SHTI-së;

dh) Ofron asistencë teknike për të gjitha institucionet në fushën e investimeve në SHTI;

e) Promovon ngritjen e strukturave të SHTI-së në të gjitha nivelet;

ë) Promovon bashkëpunimin me sektorin privat në fushën e SHTI-së;

f) Promovon, ofron ekspertizë, bashkërendon dhe monitoron bashkëpunimin dy dhe shumëplanësh me BE-në, vendet e veçanta dhe organizatat e huaja, në fushën e SHTI-së;

g) Zbaton politikat e qeverisë për mbështetjen me përparësi të shkencëtarëve më të kualifikuar, të grupeve kërkimore dhe qendrave të ekselencës, në SHTI;

gj) Zbaton politikat e qeverisë për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve dhe të shkencëtarëve të rinj në veprimtarinë e SHTI-së;

h) Zbaton politikat nxitëse të qeverisë për kthimin e trurit dhe rritjen e angazhimit të diasporës intelektuale shqiptare në zhvillimin e arsimit, të shkencës, administratës publike dhe sektorit privat në vendin tonë;

i) Ofron mbështetje teknike për institucionet ekzekutive, legjislativin dhe institucionet e tjera, për përmirësimin e plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe nënligjor, në fushën e SHTI-së.

4. AKTI-ja është institucion buxhetor dhe financohet nga:

a) Buxheti i Shtetit, në formë granti, zëri "Fondi për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (FSHTI)", në nënzërat e mëposhtëm:

i) Fondi për programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit;

ii) Fondi për infrastrukturën e kërkimit;

iii) Fondi për qendrat e ekselencës në kërkim;

iv) Fondi për transferimin e teknologjisë dhe inovacionin;

v) Fondi për kërkuesit e rinj;

vi) Fondi për programin Brain Gain.

b) Mjete financiare nga:

i) palë të treta, të destinuara për SHTI-në;

ii) nga programet dhe projektet e BE-së, të shteteve të veçanta dhe të organizatave partnere;

iii) donacione të subjekteve fizike dhe juridike, të vendit dhe të huaja;

iv) nga sektori privat, vendas dhe i huaj.

5. AKTI-ja e përdor buxhetin për fondin e pagave të punonjësve dhe për shpenzime të tjera, në funksion të përmbushjes së funksionimit dhe realizimit të detyrave të agjencisë.

6. Organet e drejtimit të AKTI-së janë:

a) Bordi drejtues;

b) Drejtori i përgjithshëm.

7. Bordi drejtues është organi kolegjial vendimmarrës i AKTI-së, që kryesohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

7.1 Në përbërje të bordit drejtues, që miratohet me urdhër të Kryeministrit, janë:

- Zëvendësministri i Financave, që mbulon çështjet e buxhetit;

- Zëvendësministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që mbulon çështjet e teknologjisë dhe të inovacionit;

- Zëvendësministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

- Zëvendësministri i Shëndetësisë;

- Kryetari i Konferencës së Rektorëve;

- Sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave;

- Një përfaqësues nga shkollat e larta private, me, së paku, gradën shkencore "Doktor", i cili propozohet nga Konferenca e Rektorëve, për një periudhë 4-vjeçare;

- Kryetari i Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë.

7.2 Funksionet kryesore të bordit drejtues janë:

a) Propozon pranë Kryeministrit fondin e nevojshëm për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin dhe për funksionimin e AKTI-së;

b) Miraton financimin e programeve dhe të projekteve të SHTI-së, në përputhje me:

i) FSHTI-në, parashikuar në ligjin e buxhetit;

ii) përparësitë e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

iii) vlerësimin e komisioneve të vlerësimit të programeve dhe projekteve;

c) Autorizon drejtorin e përgjithshëm të AKTI-së për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të programeve dhe projekteve të miratuara;

ç) Miraton raportin e veprimtarisë së AKTI-së, që i dërgohet Kryeministrit dhe bëhet publik;

d) Organizon konkursin për drejtorin e përgjithshëm të AKTI-së;

dh) Miraton përbërjen e komisioneve të vlerësimit të programeve dhe projekteve, sipas fushave të shkencës, në bazë të propozimit të drejtorit të përgjithshëmn të AKTI-së;

e) Shqyrton dhe miraton raportet e monitorimit dhe të vlerësimit të programeve dhe projekteve, të financuara nga AKTI-ja.

7.3 Bordi funksionon sipas parimit të barazisë së anëtarëve.

7.4 Kryetari dhe anëtarët e bordit përfitojnë një shpërblim mujor, të barabartë me 15 për qind të pagës së sekretarit të përgjithshëm të ministrisë. Bordi mblidhet jo më pak se 6 herë në vit.

8. Drejtori i përgjithshëm i AKTI-së është titullari i institucionit dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretë.

8.1 Drejtori i përgjithshëm i AKTI-së duhet të ketë gradën shkencore "Doktor", të ketë kontribut të njohur në fushën e shkencës, të teknologjisë dhe inovacionit.

8.2 Drejtori i përgjithshëm i AKTI-së përzgjidhet nga bordi drejtues i agjencisë dhe emërohet nga Kryeministri, për një mandat prej 4 vjetësh, me të drejtë riemërimi. Ai mund të shkarkohet përpara përfundimit të mandatit, me propozimin e bordit drejtues ose me nismën e Kryeministrit.

8.3 Bordi drejtues i propozon Kryeministrit 3 kandidatë, të përzgjedhur me konkurs, i cili zhvillohet në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil.

9. AKTI-ja, për çështjet e përmbajtjes dhe të vlerësimit të programeve e të projekteve, mbështetet me ekspertizë nga komisionet e vlerësimit të programeve e projekteve, që propozohen nga drejtori i Përgjithshëm dhe miratohen nga bordi drejtues, në përputhje me rregulloren e funksionimit të kësaj agjencie.

10. AKTI-ja ka, gjithsej, 15 punonjës. Struktura dhe organika e kësaj agjencie miratohet brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, me urdhër të Kryeministrit.

11. Funksionimi i AKTI-së rregullohet në përputhje me rregulloren e funksionimit të kësaj agjencie, e cila përgatitet nga drejtori i përgjithshëm, në bashkëpunim me bordin drejtues, dhe miratohet me urdhër të Kryeministrit.

12. Procedurat e emërimit të personelit janë në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil, dhe aktet nënligjore e në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim. Pagat e personelit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

13. Kryeministria të sigurojë mjediset e punës për vendosjen e AKTI-së.

14. Anëtarët e bordit dhe drejtori i AKTI-së emërohen brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

15. Për vitin 2009, AKTI-ja financohet nga buxheti i miratuar për Kryeministrinë.

16. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, zëri "Investime", t'i shtohen 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për rikonstruksionin dhe pajisjen e mjediseve të punës dhe 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për fondin e pagave dhe shpenzimet e tjera, të nevojshme për veprimtarinë e AKTI-së, për këtë vit.

17. Fondet e përmendura, në pikën 16 të këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

18. Administrimi i programeve, i projekteve të kërkimit e të zhvillimit dhe i programeve të tjera, të cilat përfshihen në veprimtarinë e AKTI-së, por, që aktualisht realizohen nga institucionet e tjera, t'i transferohet plotësisht kësaj agjencie, në 1 janar 2010.

19. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.916, datë 15.7.2009**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 3 shtohet emërtimi:

"- Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale.".

2. Në fund të pikës 4 shtohen emërtimet:

"- Këshilltarët e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale;

- Drejtorët e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale;

- Sekretar i Përgjtihshëm, pranë ILDKP-së;

- Drejtor i kabinetit, pranë ILDKP-së.".

3. Në fund të pikës 4, emërtimi "Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse të ILDKP-së", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

| | |
|---|---|
| KODI I PROCEDURËS CIVILE ..... | 240 lekë |
| KODI PENAL ..... | 226 lekë |
| KODI I PROCEDURËS PENALE..... | 330 lekë |
| KODI CIVIL ..... | 410 lekë |
| KODI I PUNËS ..... | 140 lekë |
| KODI PENAL USHTARAK ..... | 55 lekë |
| KODI I FAMILJES ..... | 270 lekë |
| KUSHTETUTA ..... | 95 lekë |
| KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE ..... | 90 lekë |

Hyri në shtyp më 22.9.2009
Doli nga shtypi më 23.9.2009

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 3300 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 8 lekë